

01-206



Republika e Kosovës
 Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
 Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 49, 50 dhe 51 të Ligjit Nr.2004/15 të dt. 27.05.2004 nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 351/04-31667/23 dt. 10.02.2023, të pronarëve Bekim Halimi dhe Shukrije Agushi me investitor npn “Nderimi”- Ferizaj, me përfaqësues Shaban Aliu, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën banimore-afariste “Objekti A”, me etazhitet B+S+P+7, në lagjen “Mati 1” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datën 17.05.2023 lëshon këtë:

V E N D I M
CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LËSHOHET Certifikata e përdorimit pronarëve Bekim Halimi dhe Shukrije Agushi me investitor N.P.N. “Nderimi”- Ferizaj, me përfaqësues Shaban Aliu, sipas kërkesës 05 Nr. 351/04-31667/23 dt. 10.02.2023, për përdorimin e ndërtesës banimore-afariste “Objekti A”, me etazhitet B+S+P+7, e ndërtuar në kuadër të bllokut urbanistik “C3”, në lagjen “Mati 1” konkretisht në parcelën kadastrale nr. 01552-1, ZK Matiçan, sipas Vendimit 05 Nr. 351-39194 dt. 29.01.2013 për lejimin e ndërtimit të ndërtesës.

II. Ndërtesa, mund të përdoret, sipas destinimit të përcaktuar në pikën I. të Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-39194 dt. 29.01.2013, dokumentacionit ndërtimor dhe Raportit të Komisionit profesional të pranimit teknik të ndërtesës.

III. Ndërtesa mund të përdoret nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate.

IV. Kjo Certifikatë shërben për regjistrimin e ndërtesës në regjistrin kadastral të përshkruar në pikën I. të këtij vendimi.

A r s y e t i m

Pronarët Bekim Halimi dhe Shukrije Agushi me investitor npn “Nderimi”- Ferizaj, me përfaqësues Shaban Aliu, më kërkesën me 05 Nr. 351/04-31667/23 dt. 10.02.2023, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për përdorimin e ndërtesës banimore-afariste “Objekti A”, me etazhitet B+S+P+7, në lokacionin e përshkruar si në pikën I. të dispozitivit të kësaj certificate.

Me kërkesë, investitori ka prezantuar:

- Aktvendimi nr. 05 Nr. 351-39194 dt. 29.01.2013 për lejimin e ndërtimit të ndërtesës objekt banimor-afarist Objekti A, me etazhitet B+S+P+7 të pronarëve Bekim Halimi dhe Shukrije Agushi me investitor npn “Nderimi”- Ferizaj, në kuadër të bllokut urbanistik C3, në lagjen “Mati 1” konkretisht në parcelën kadastrale nr. 01552-1, ZK Matiçan.

- Aktvendimi nr. 05 Nr. 351-39194 dt. 12.12.2012 mbi kompensimin për rregullimin e tokës ndërtimore të pronarëve Bekim Halimi dhe Shukrije Agushi me investitor nprn “Nderimi”-Ferizaj.
- Informim mbi caktimin e adresës për objektin me nr. të referencës 05-015/2-0142564/17 dt. 14.06.2017, rr. “Uran Ajeti” me nr. e hyrjes/daljes 130, 132, 134, 136, 138, 140.
- Procesverbalin mbi kontrollimin teknik të ndërtesës nga komisioni profesional i emëruar nga kjo Drejtori sipas Vendimit me nr. 05 Nr. 391/02-185891/20 dt. 17.11.2022.
- Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01,
- Atestet e materialeve dhe rezultatet e testimeve,
- Fotografi gjatë procesit të ndërtimit,
- Certifikata e pronës dhe kopja e planit

Drejtorja e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, konkretisht Raportit të Komisionit profesional të pranimit teknik të ndërtesës të ndërtimit të ndërtesës dhe të dokumentacionit të dorëzuar nga ana e investitorit, ka konstatuar:

Ndërtesa banimore-afariste “Objekti A”, me etazhitet B+S+P+7 është ndërtuar në pajtim me Vendimet e cekura më lartë dhe dokumentacionin tjetër teknik dhe se i njëjti i përmush normativat dhe standardet, aplikimi i të cilave është i domosdoshëm me rastin e ndërtimit të ndërtesave të tilla, kështu që ndërtesa në fjalë mund të përdoret/shfrytëzohet, gjegjësisht të lëshohet certifikata e përdorimit.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certificate, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPH-ja.

I dorëzohet: Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 351/04-31667/23 DT. 17.05.2023**


Zyrtari:

Arbër Morina



Udhëheqëse e sektorit

Nazife Krasniqi



Drejtori:

Arber Sadiki

